REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E PODUJEVËS/OPŠTINA PODUJEVO/MUNICIPALITY OF PODUJEVA
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE

Dërguar më / Dostavljeno		
06. 10. 2026		
Njësi org. / Org. jed.	Nr. / Br.	Shtojcë - / Prilog
01-463/06-0061379/26		

PODUJEVË - PODUJEVO

Republika e Kosovës | Republika Kosova | Republic of Kosova

Komuna e Podujevës | Opština Podujevo | Municipality of Podujeva

Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në ZK:Orllan
Nr: 01-020/04-0019211/26 të datës 31.03.2026

Nr: 01-463/06-0061379/26
Data: 06.10.2026

Në mbështetje të Paragrafit 1.1 të Nenit 6,Paragrafi 1.2 i Nenit 8, Nenit 15 Paragrafit 1, Neni 17 të Ligjit Nr:06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, të Nenit 14 të rregullores (QRK) Nr:09/2020 për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës,të vendimit të Kuvendit Komunal Nr: 01-463/06-0019209/26 të datës 31.03.2026 për miratim paraprak të Pronës së Paluajtshme Komunale, Vendimin e Kuvendit Komunal Nr: 01-020/04-0019211/26 të datës 31.03.2026 për Zgjedhjen e Komisionit Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale në ZK:Orllan
Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale SHPALLË:

N J O F T I M P U B L I K
PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM

1	Emërtimi, lokacioni, përshkrimi, sipërfaqja, destinimi dhe pronësia e parcelës:	Prona e miratuar nga Kuvendi për dhënien në shfrytëzim është: 1. Pjesë e parcelës , Lokacioni ZK:Orllan, parcela P-71712058-01339-0 me sipërfaqe prej 2106 m², nga kjo njësi sipërfaqja e planifikuar për dhënje në shfrytëzim është 1250 m² duke përfshirë objektin hotelier prej 250 m² në vendin e quajtur "fshat Orllan" me shfrytëzim aktual Oborr, shtëpi-ndërtesë, me destinim sipas hartës zonale kadastrale-zonë e dytë e mbrojtur
2	Kohëzgjatja e shfrytëzimit dhe kufizimit për aplikim:	Dhënie në shfrytëzim deri në afat prej 10 viteve me kompensim për shfrytëzim me pëlqim të pronarit dhe në pajtim me ligjin në fuqi.
3	Çfarëdo kushti apo kufizimi mbi dhënien e të drejtave për shfrytëzim:	- Fillimi i investimeve kapitale brenda 1 muaji dhe përfundimi i investimeve kapitale si dhe fillimi i veprimtaris brenda 2 muajve. - Punësimi sipas planit të biznesit - Investimet sipas planit të biznesit - Shfrytëzuesi nuk ka të drejt që në asnjë mënyrë që pronen e marr në shfrytëzim ta bartë tek personi i tretë me qera apo në qfardo mënyre tjetër, në të kundërtën pronari (Kuvendi i Komunës) e ka të drejtën e shkëputjes së njëanëshme të kontratës pa paralajmërim. - Shfrytëzuesi nuk ka të drejtë në asnjë mënyrë që parcelën të marrë në shfrytëzim ta lenë në Hipotekë në të kundërën pronari (Kuvendi i Komunës) e ka të drejtën e shkëputjes së njëanëshme të kontratës pa paralajmërim. - Shfrytëzuesi nuk ka të drejtë ta ndërroi veprimtarin e biznesit me të cilën ka aplikuar, pronari (Kuvendi i Komunës) e ka të drejtën e shkëputjes së njëanëshme të kontratës pa paralajmërim.

4	Forma e Konkurimit	- Ankand publik.
5	Çmimi fillestarë:	- Së paku 1.00 € m2, Qera mujore, (Pagesa hynë në fuqi nga data e nënshkrimit të kontratës).
6	Kriteret për pjesëmarrje në konkurim:	- Aplikacioni - Çertifikata e rexhistrimit të biznesit (nëse është ekzistues) - Plani i biznesit i cili duhet të përmbajë: Fillimin e investimeve brenda 1 muaji, numrin e punëtorëve, vlerën e investimeve dhe llojin e veprimtarisë që do ta ushtroni, historikun e biznesit (nëse është ekzistues). - Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve të tatimit në pronë - Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve ndaj ATK-së (për bizneset egzistuese). - Dëshmia nga ATK-ja për numrin aktual të të punësuarve (për bizneset ekzistuese). - Dëshmia nga ATK-ja për qarkullimin e biznesit për 2 vitet e fundit (për bizneset ekzistuese).
7	Procedurat e rexhistrimit të oferuesve:	- Ofertuesit mund të aplikojnë nga data e publikimit për 15 ditë kalendarik. - Aplikacionet merren në zyrën për shërbim të qytetarve në objektin e Komunës. Po ashtu konkursin mund ta gjeni në ueb faqen zyrtare **https://podujeve.rks-gov.net/njoftimet-shpalljet-konkurset/ ku edhe munda ta shkarkoni aplikacionin.** - Aplikimi bëhet në zyrën për shërbim të qytetarve në objektin e Komunës jo më largë se datën e fundit për aplikim.
8	Afati i fundit për aplikim është:	- Afati i fundit për aplikim është 20.10.2026 ora: 16:00
9	Koha dhe vendi ku mbahet hapja e ofertave:	- Hapja ofertave mbahet me datën: 21.10.2026 në ora: 10:00 në Ndërtesën e Komunës Kati I, Salla e Kuvendit.

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- Aplikacioni
- Kopja e letërnjoftimit
- Çertifikata e rexhistrimit të biznesit (nëse është ekzistues)
- Plani i biznesit i cili duhet të përmbajë: Fillimin e investimeve brenda 1 muaji, numrin e punëtorëve, vlerën e investimeve dhe llojin e veprimtarisë që do ta ushtroni, historikun e biznesit (nëse është ekzistues).
- Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve të tatimit në pronë
- Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve ndaj ATK-së (për bizneset ekzistuese).
- Dëshmia nga ATK-ja për numrin aktual të të punësuarve (për bizneset ekzistuese).
- Dëshmia nga ATK-ja për qarkullimin e biznesit për 2 vitet e fundit (për bizneset ekzistuese).

Kriteret për zgjedhjen e ofertave:

- Vlera e investimeve dhe viprimtaria biznesore
- Numri i të punësuarve nga investimi
- Lloji i investimit që është në interes publik
- Përfitimi financiar i Komunës
- Kriteret tjera të cilat janë parapara në këtë njoftim.

Pjesëmarrësve në konkurrim u garantohet e drejta që:

- Të informohen me procedurat e shprehjes së interesit,
- Të shohin pronën që jepet në shfrytëzim
- Të kenë qasje në dokumentacionin e pronës
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tri (3) ditë para hapjes së ofertave.

Anëtarët e Komisionit:

1. Ditjona Statovci, kryesus _____
2. Haki Rudari, anëtare _____
3. Vigan Salihu, anëtare _____
4. Isak Ejupi, anëtar _____
5. Shqipdon Rushiti, anëtar _____